

UDHËZIM
Nr. 22, datë 2.10.2012

**PËR ZBATIMIN E AKTIT NORMATIV NR. 5, DATË 26.9.2012 “PËR DISA NDRYSHIME NË
LIGJIN NR. 10 487, DATË 5.12.2011 “PËR BUXHETIN E VITIT 2012””**

Në mbështetje të nenit 104 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të aktit normativ nr. 5, datë 26.9.2012 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në të gjitha rastet kur transferta e pakushtëzuar në kolonën 1 të tabelës 3 të aktit normativ nr. 5, datë 26.9.2012 është më e vogël sesa transferta e pakushtëzuar në tabelën 3 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, njësia e qeverisjes vendore duhet të kryejë rishikimin e buxhetit (në këshillin e bashkisë/komunës) në përputhje me rregullat e rishikimit të buxhetit të përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, për të bërë shkurtimet e nevojshme.

2. Subvencioni për energji elektrike për furnizimin me ujë të pijshëm i paraqitur në kolonën 2 të tabelës 3 të aktit normativ nr. 5, datë 26.9.2012, do të përdoret vetëm për këtë destinacion dhe nuk është e nevojshme të miratohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore.

3. Për pjesën e subvencionit që u takon sh.a. ujësjellës-kanalizimeve, çelja e fondit të subvencionit në sistemin informatik-financiar të qeverisë do të bëhet në kodin e klasifikimit funksional të çdo sh.a. ujësjellës-kanalizimeve, si njësi shpenzuese e veçantë në varësi të njësive/njësisë vendore (shih tabelën bashkëlidhur). Struktura buxhetore në të cilën do të bëhet çelja është:

EQ	Gr.	Kod instit.	Emër institucioni	Nr. kapit.	Nr. program.	Nr. artik.	Kod. D. Thesarit	Vlera (lekë)
XXX	00	2XXXXX	Sh.a.Ujësjellës-Kanalizime XXX	05	01110	6030000	XXXX	XXXXXX

4. Për subvencionin që i takon njësisë vendore, për sistemin e pompimit, çelja e fondit do të bëhet në kodin ekzistues të njësisë vendore (shih tabelën bashkëlidhur). Struktura buxhetore në të cilën do të bëhet çelja është:

EQ	Gr.	Kod instit.	Emër institucioni	Nr. kapit.	Nr. program.	Nr. artik.	Kod. D. Thesarit	Vlera (lekë)
XXX	00	2XXXXX	Bashkia/komuna XXXXX	05	01110	6030000	XXXX	XXXXXX

5. Me marrjen e njoftimit për çeljen e fondit nga struktura përgjegjëse për buxhetin në qendër, pranë Ministrisë së Financave, ndërmarrja e ujësjellësit sh.a., përgatit urdhërshpenzimin, të cilin e paraqet pranë degës përkatëse të thesarit për kryerjen e pagesës, në llogarinë bankare të operatorit “CEZ shpërndarje” sh.a., në zbatim të procedurave ekzistuese të sistemit të thesarit.

Urdhërshpenzimi do të plotësohet nga njësiti vendore (për sistemin e pompimit) dhe ndërmarrjet e ujësjellësit sh.a. me llogarinë ekonomike 6030006 - subvencion për diferencë çmimi për furnizim me ujë të pijshëm.

6. Realizimi i fondit të subvencionit për energji elektrike për furnizimin me ujë të pijshëm do të raportohet periodikisht në treguesit fiskalë të qeverisjes vendore.

7. Transferta e pakushtëzuar dhe subvencioni për energji elektrike për furnizimin me ujë të pijshëm të papërdorur gjatë vitit buxhetor, trashëgohet në vitin buxhetor pasardhës.

8. Subvencioni për energji elektrike për furnizimin me ujë të pijshëm i trashëguar nga viti i mëparshëm buxhetor, përdoret në vitin pasardhës buxhetor për të njëjtin destinacion, pra për shlyerjen e

detyrimeve të energjisë elektrike ndaj “CEZ shpërndarje” sh.a.

9. Udhëzimi hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode